



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH.II.nr.1515/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Faton Bajrami, kryetar i kolegjit, Franciska Zhitia Ymeri dhe Saranda Bogaj Sheremeti, anëtar të kolegjit, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit “Uzi Group” ShPK me seli në Prishtinë, kundër të paditurës Dogana e Kosovës (DK) në Prishtinë, me bazë juridike, anulim vendimi, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës, ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e shkallës së pare - Departamenti Fiskal, KF.nr.352/2022, të datës 09.10.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 08.05.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa e të paditurës Dogana e Kosovës në Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës të Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e shkallës së pare - Departamenti Fiskal, KF.nr.352/2022, të datës 09.10.2023, vërtetohet.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës të Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e shkallës së pare -Departamenti Fiskal, KF.nr.352/2022, të datës 09.10.2023, nën pikën I të dispozitivit të aktgjykimit është APROVOHET NË TËRSI si e bazuar kërkesëpadia e paditësit Uzi Group Sh.P.K. me seli në Prishtinë,. II. ANULOHET aktvendimi i të paditurës, Dogana e Kosovës në Prishtinë, nr. 01.3.2/6658, 7761 i datës 24.05.2021. III. OBLIGOHET e paditura Dogana e Kosovës me seli në Prishtinë, që paditësit Uzi Group Sh.P.K. me seli në Prishtinë, t’ia kompensoj shumën prej 9,148.00 €, (nëntëmijë/e/njëqind/e/dyzetë/e/tetë/euro) në emër të dëmit real, për shkak të mos realizimit të importit sipas deklaratës unike doganore R-22795/02.04.2021, shumën prej 5,671.76 €, (pesëmijë/e/gjashtëqind/e/shtatëdhjetë/e/një/euro/e/shtatëdhjetë/e/gjashtë/centë), në emër të fitimit të humbur, e të gjitha këto në shumën e përgjithshme prej 14,819.76 €, (katërbëdhjetë/mijë/e/tetëqind/e/nëntëmbëdhjetë /euro/e/shtatëdhjetë/e/gjashtë/centë), me kamatë ligjore prej 8% nga data e paraqitjes së padisë 25.06.2021, e deri në pagesën definitive, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi. IV. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedural.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë e paditura Dogana e Kosovës, për shkak të: shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale. Me propozim që ta aprovon ankesën në tërësi si të bazuar në ligj, ndërsa aktgjykimin KF.nr.352/22, të datës 09.10.2023 ta prish si të pa bazuar në ligj, dhe ta refuzon padinë dhe kërkesën e paditësit në tërësi si të pa bazuar në ligj, dhe t’ia kthejë lëndën gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim dhe rivendosje.

Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore, përgjigjen në ankesë, dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 49 të LKA, nenit 81.H të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat nr.03/L-222, lidhur me nenin 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), gjeti se:

- Ankesa është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se me aktvendimin e kundërshtuar nr.01.3.2.2/6658, 7761 i datës 24.05.2021, të Doganës së Kosovës në Prishtinë, është refuzuar si e pa bazuar kërkesa e subjektit në procedure “Uzi Group” SH.P.K me seli në Prishtinë, për rishqyrtimin e vendimit nr.6324/1 datë 14.04.2021 i Departamentit Rajonal Doganor – Prishtinë, si e pa bazuar. Mbetet në fuqi vendimi nr. prot 6324/1 datë 14.04.2021 i lëshuar nga Departamenti Rajonal Doganor Prishtinë.

Paditësi i pakënaqur me aktvendimin e lartcekur të paditurës Dogana e Kosovës në Prishtinë, ka ushtruar padi për konflikt administrativ me datën 25.06.2021, me pretendim se i njëjti është i pa drejtë dhe i pa ligjshëm.

Gjykata e shkallës së parë, pas shqyrtimit të padisë së paditësit paraqitur kundër aktvendimit nr.01.3.2.2/6658, 7761 i datës 24.05.2021, të Doganës së Kosovës në Prishtinë, dhe pas administrimit të provave si në procesverbal të shqyrtimit kryesor, e duke u bazuar edhe në provat dhe dëshmitë e tjera të lëndës, bie aktgjykimin e ankimuar me të cilin kërkesëpadinë e paditësit e aprovon si të bazuar, duke vendosur sikurse në dispozitiv të aktgjykimit. Me arsyetim se në rastin konkret mbetet kontestues, vetëm malli i konfiskuar me Aktvendimin 02.1.1.2/17327/1 të datës 09.09.2021, dhe i futur në depo të doganës me deklaratën DE 880/26.10.2021, në vlerë prej 9,148.00 euro, dhe dëmi i shkaktuar nga ky konfiskim i mallit, e që ky mall nuk është lejuar të zhdoganohet sipas deklaratës unike doganore si më lartë dhe është konfiskuar me Aktvendimin 02.1.1.2/17327/1 i datës 09.09.2021, dhe i njëjti mall nën deklaratën DE 880/26.10.2021 është futur në depon e doganës për trajtim të mëtutjeshëm, ndërsa një pjesë e malli sipas faturës kontestuese për të cilin mall nuk ka vendosur kufizime shtesë e paditura i njëjti mall është zhdoganuar me deklaratën unike doganore R22759/02.04.2021, dhe është liruar në qarkullim të lirë në Kosovë. Gjykata konstaton se e paditura vendimin kontestues e ka nxjerr bazuar në informatat nga takimi i përbashkët Doganë – MTI i datës 08 dhe 09/02.2021, nga kanë dalë edhe minutat e takimit e ku është theksuar se subjektet që importojnë mallin letër në formë tubi me filtër për mbushje të duhanit, përveç licencës së importit të lëshuar nga MTI-ja, duhet prezantohet edhe licenca/leja/regjistrimi që kërkohet për përpunim industrial të duhanit sipas ligjit 04/L-041 dhe licencën e paraparë me nenin 11 të ligjit 04L-021. Për të vërtetuar konstatimet e cekura si në arsyetimin e vendimit kontestues dhe pretendimet e paditësit të paraqitura në padi dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor, Gjykata sipas propozimit të autorizuarit të palës paditëse përmes aktvendimit KF.nr.352/2022 të datës 12.06.2023 ka caktuar ekspertizë financiare në këtë kontekst tregtar administrativ me ekspertin financiare V.H. dhe me detyra përkatëse. Ekspertja financiare si në ekspertizë dhe në plotësim të saj ka theksuar se për importin e mallrave të deklaruara sipas kodit tarifor 4812100000 kërkohet licenca L05, tutje ka theksuar se malli që ka dalë në qarkullim të lirë është zhdoganuar me R22759/02.04.2021, ndërsa malli apo artikujt e konfiskuar kanë kaluar në DE 7 R880/26.10.2021, ndërsa gjatë sqarimeve të dhëna në seancë ka theksuar se : sqaroj se vlera e mallit të konfiskuar siç është cekur në konstatimin nr. 2 në plotësim ekspertizë është 9,148.00€, kësaj shume i shtohet edhe marzha e fitimit prej 62% e cila marzha paraqet mesataren e shitjes për secilin artikuj që në vlerë financiare nënkupton 5,671.76€, e që

të dyja bashkë arrijnë shumën prej 14,819.67€, në të cilën shumë duhet të llogaritet edhe kamata prej 8%.

Qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e pranon edhe kjo gjykatë, për arsye se aktgjykimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative, të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative. Gjykata e shkallës së parë duke vlerësuar ligjshmërinë e aktvendimit të kontestuar në kuptim të dispozitave të nenit 81G të Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat nr. 03/L-222 dhe nenit 38 të Ligjit për Konfliktet Administrative, në drejtim të thënieve në padi, në përgjigje në padi, provave të administruara në seancë gjyqësore si dhe pas shqyrtimit të shkresave të tjera të lëndës, me të drejtë ka konstatuar se kërkesëpapia e paditësit është e bazuar.

Sa i përket pretendimeve ankimore të paditurës për shkelje esenciale të dispozitave të procedurës, këto pretendime ankimore nuk qëndrojnë, meqë gjykata e shkallës së parë ka shqyrtuar padinë, fillimisht i ka dërguar padinë përfaqësuesit të paditurës në përgjigje në padi, pastaj ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor, ka nxjerrë prova të mjaftueshme, që do të thotë se gjatë vlerësimit gjykata e shkallës së parë nuk ka bërë shkelje esenciale të dispozitave LKA-së, Ligjit Nr.04/L-102 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës, si dhe të LPK-së.

Ndërsa sa i përket pretendimeve ankimore për vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, se gjykata e shkallës së parë nuk ka vërtetuar se a duhet të pajiset me licencë paditësi për mallin në fjalë. Këto pretendime ankimore kolegji i kësaj gjykate nuk i aprovoj, ngase të njëjtat janë të pa argumentuara dhe të pa qëndrueshme në vërtetimin e gjendjes tjetër faktike nga ajo e vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë. Sepse Gjykata ka gjetur se këtu paditësi përmes deklaratës unike doganore 22759/02.04.2021, ka deklaruar për zhdoganim mallin kontestues letër për cigare me kod tarifor 4813100000, kod ky i cili kërkon licencën LO5, licence kjo e cila është paraqitur nga këtu paditësi dhe e njëjta bart numrin 49 dhe është e datës 20.01.2021, e lëshuar nga MTI-ja, dhe se ky lloj i licencës i referohet importit të letrës për cigare dhe letrës në formë tubi me filtër. Tutje Gjykata ka gjetur se përveç licencës si më lartë, malli i deklaruar me DUD-in R22759/02.04.2021, është përcjell edhe me faturën e mallit, nr. 2021-60370, me packing list dhe me deklaratën eksportuese EX Z, të shtetit eksportues, dokumente këto jo kontestuese. Gjykata ka elaboruar edhe kapitullin 48 të TARIK-ut, dhe konkretisht kodin tarifor 4813100000, kod ky në të cilin është deklaruar malli kontestues për zhdoganim dhe nga masat e politikës tregtare të përcaktuara në TARIK-ë lidhur me këtë kod tarifor jo kontestues gjejmë se sikurse për import ashtu edhe për eksport për mallrat e deklaruara me këtë kod tarifor kërkohet vetëm licenca LO5, e që në rastin konkret kjo licencë nënkupton licencën nr. 49 të datës 20.01.2021. Gjithashtu gjykata ka vlerësuar se nuk qëndron pretendimi i të paditurës se këtu paditësit i është dhënë mundësia në procedurë administrative t'i jap një tretman të lejuar doganore mallrave për të cilat importi nuk është lejuar dhe atë komfor nenit 180 të KDA-së, kjo për faktin se ky nen gjen zbatim vetëm në rastet kur subjekti që bën deklaram të mallit, nuk i plotëson kushtet për lëshim të mallin në qarkullim të lirë në Kosovë, e jo sikurse në rastin konkret kur këtu paditësi i ka plotësuar të gjitha kushtet ligjore dhe kushtet e përcaktuara me masat e politikës tregtare sipas TARIK-ut, respektivisht kodit tarifor 4813100000 dhe me të drejtë edhe ka deklaruar mallin për zhdoganim sipas DUD-it 22759/02.04.2021. Andaj, Gjykata vlerëson se e paditura nuk mund të përcaktoj kushte shtesë, në këtë rast licenca/leje/regjistrime bazuar në

takime të realizuara qoftë me MTI apo institucion tjetër përveç atyre të përcaktuara më ligj. Po ashtu edhe pretendimi tjetër i palës së paditur se këtu paditësi nuk ka arritur të siguroj licencën që kërkohet sipas ligjit 04/L-041, nuk qëndron, kjo për faktin se është shumë e qartë se licenca nr. 49 e datës 20.01.2021, e paraqitur/deklaruar nga këtu paditësi që nga faza e zhdoganimit e tutje, është licencë për import të letrës për cigare dhe letrës në formë tubi me filtër e mbështetur në nenin 17, të ligjit nr. 04/L-041, për prodhimin, grumbullimin, përpunimin dhe tregtimin e duhanit, dhe në UA nr. 11/2020 për përcaktimin e kushteve dhe kriterëve për subjektet që merren me tregtimin e duhanit dhe produkteve të tij, licenca i lëshohet UZI Group Sh.P.K. me seli në Prishtinë. Ligji 04/L-041 në nenin 17 ka përcaktuar qartë se : *Subjektet që merren me tregtimin e duhanit dhe produkteve të tij pajisen me licencën përkatëse për ushtrimin e këtij aktiviteti nga MTI. 2. Asnjë subjekt, vendor apo i huaj nuk mund të tregtoje duhanin apo produktet e tij pa u pajisur me licencën përkatëse. 3. Subjektet që zhvillojnë aktivitete tregtare, pasi të jenë të regjistruar në MTI sipas këtij ligji, duhet të aplikojnë për lejen e importit të duhanit dhe produkteve të tij në AUV. 4. Kriteret dhe kushtet për dhëniën e licencës së subjekteve që zhvillojnë aktivitete të biznesit nga paragrafi 3. i këtij neni rregullohen me akt nënligjor nga MTI.*

Nga tërë kjo që u cek më lartë dhe mbi këtë gjendje faktike, kjo gjykatë konsideron se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, ngase nuk është cenuar ligji në dëm të paditurës. Prandaj, pretendimet ankimore në ankesë se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar edhe të drejtën materiale në dëm të paditurës, ky kolegji nuk i aprovoi, sepse vlerësoi se te njëjtat janë të paqëndrueshme dhe të pa bazuara për tu aprovuar ankesa, dhe se janë të pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike nga ajo e vërtetuar edhe nga gjykata e shkallës së parë. Sepse, aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë, është i qartë dhe i kuptueshëm si dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare, të cilat i pranon edhe kjo gjykatë, andaj, ankesa e të paditurës u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm. Duke marrë parasysh se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale, me rastin e aprovimit të kërkesëpadisë së paditëses, e pasi që me pretendimet tjera ankimore të përsëritura, të njëpasnjëshme, një aktgjykim i tillë nuk mund të vihet në pyetje, ankesa e të paditurës u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e Shkallës së Dytë
K.DH.SH.II.nr.1515/23, me datë 08.05.2024

Kryetar i kolegjit,
Faton Bajrami